

DEKRET
Nr. 446, datë 5.12.2025

PËR DHËNIE DEKORATE

Në mbështetje të nenit 92, germa “ç”, nenit 93 të Kushtetutës, nenit 6, pika 1, të ligjit nr. 93/2022, “Për dekoratat në Republikën e Shqipërisë”, me propozim të Kryeministrit,

DEKRETOJ:

Neni 1

**Dhënien e dekoratës “Ylli i Madh i Urdhrit të Lisit Akademik”
zotit Ismet Elezi**

“Në shenjë vlerësimi për kontributin e jashtëzakonshëm në zhvillimin e shkencës juridike shqiptare, për veprën e tij të gjerë dhe rolin e pazëvendësueshëm në formimin e brezave të juristëve në Shqipëri dhe Kosovë. Për kontributin e tij themelor në pasurimin e kulturës juridike kombëtare, përkrahjen e kërkimit shkencor dhe standardeve akademike në fushën e së drejtës penale dhe të së drejtës zakonore”.

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENT I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj